

V E N D I M
Nr.10, datë 6.12.1993

PËR TRAJTIMIN E BANESAVE TË EMIGRANTËVE EKONOMIKË A POLITIKË

Në zbatim të ligjit nr.7672, datë 11.2.1993 “Për një shtesë në ligjin nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rastet kur banesa e emigrantit ekonomik a politik i është dhënë një qytetari tjetër me autorizim të organeve të pushtetit lokal dhe është lidhur kontrata e qirasë me Ndërmarrjen Komunale Banesa, sipas rregullave në fuqi deri në datën 31.12.1992, nuk bëhet privatizimi i saj dhe qytetarët që banojnë aktualisht në këto banesa, do të qëndrojnë si qiramarrës deri në datën 31.12.1995.

Këta qytetarë të konsiderohen të pastrehë dhe si të tillë të trajtohen sipas nenit 16 të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, duke përfutur kredi pa interes për sistemimin e tyre me strehim brenda afatit të mësipërm.

2. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit dhe Ministria e Financave, në bashkëpunim me organet e pushtetit lokal, të marrin masa për sistemimin përfundimtar me strehim të qytetarëve të mësipërm brenda afatit të caktuar.

3. Pas datës 31.12.1995, banesat u rikthehen përsëri emigrantëve ekonomikë a politikë që i kanë pasur me kontrata të rregullta para emigrimit të tyre.

Këto banesa, pas kthimit të tyre emigrantëve ekonomikë a politikë, do t’i nënshtrohen rregullave të privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi